



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:153271

Datë: 09.08.2023

Numri i dokumentit: 04570742

PPP.nr.2746/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, gjyqtari Freskim Musliu, në çështjen përbarimore të kreditorit D . S . nga Komuna e Vushtrisë, ndaj debitorit “A . . . “sh.p.k., me seli në Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të përbarimit të ushtruar kundër urdhrin përbarimor P.nr.133/2020, të datës 13.10.2020, të përbaruesit privat I . M . nga Mitrovica, jashtë seancës me datë 09.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore P.nr.133/2020 te përbaruesit privat I . M . nga Mitrovica, në çështjen përbarimore ndërmjet kreditorit të përbarimit D . S . nga Komuna e Vushtrisë dhe debitorit të përbarimit “A . . . “sh.p.k. me seli në Komuna e Fushë Kosovës, për shkak të pagesës së borxhit në tërësi nga debitori.

A r s y e t i m

Përbaruesi privat I . M . nga Mitrovica me datë 13.10.2020 ka nxjerrë urdhrin përbarimore P.nr.133/2020, me të cilin në bazë të propozimit të kreditorit të përbarimit D . S . ka caktuar përbarimin në shumë prej 5,733.00 euro, si dhe pagesën e shpenzimeve përbarimore kundër debitorit të lartcekur. Përbarimi është caktuar në bazë të Kontratës për Qiranë LRP.12811/2018, me nr. reference 1916/2018, te datës 05.11.2018.

Debitori “A . . . “sh.p.k., me datë 19.10.2020 ka ushtruar prapësim ndaj urdhrin përbarimor të lartcekur dhe ka kërkuar nga kjo gjykatë që ta shfuqizojë urdhrin. Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit.

Më 07.08.2023 gjykata ka pranuar me shkrim njoftimin nga përmbaruesi privat i lartcekur, me të cilin e ka njoftuar gjykatën që debitori e ka përmbushur detyrimin drejtpërdrejtë në llogarinë bankare të kreditorit e po ashtu edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në llogarinë e veçantë të përmbaruesit privat. Këtij njoftimi i ka bashkëngjitur edhe parashtrirat nga kreditori dhe debitori, me të cilat njoftohet përmbaruesi se detyrimi është përmbushur.

Meqenëse kërkesa e kreditorit është realizuar jashtë procedurës së përmbarimit, atëherë gjykata në bazë të nenit 66 para. 4 të LPP-së, sipas detyrës zyrtare e përfundoi procedurën përmbarimore, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.2746/2020, me datë 09.08.2023

Gjyqtari
Freskim Musliu

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.